

Në Prishtinë vazhdojnë reagimet ndaj vendimit të Komisionit Evropian për vizat

Shoqëria civile apelon Brukselin ta përfshijë Kosovën në liberalizimin e vizave

Janë 19 persona nga shoqëria civile, në mesin e tyre edhe ish-deputetja serbe Rada Trajkoviç nga Graçanica, që kanë nënshkruar apelin me të cilin kërkojnë që Komisioni Evropian të rishqyrtojë vendimin, me të cilin Kosova është lënë jashtë procesit të liberalizimit të vizave. Lënia e Kosovës jashtë procesit u vlerësua si politike katastrofale që getoizojnë qytetarët e Kosovës, lirinë e tyre të lëvizjes dhe sigurinë e tyre si banor të Evropës

Zijadin Gashi

Shoqëria civile e Kosovës i bën apel Bashkimit Evropian dhe të gjitha institucioneve tjera në Bruksel që edhe Kosova të përfshihet në procesin e liberalizimit të vizave. Ndërsa përshëndetet futja e Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi në këtë proces, kurse u dëshirohet edhe Shqipërisë dhe Bosnjë e Hercegovinës që të përfshihen sa më shpejtë, përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë shprehin shqetësimin e tyre për faktin se Kosova ka mbetur krejt jashtë procesit. Andaj, deri dje, ishin 19 persona nga shoqëria civile, në mesin e të cilëve edhe ish-deputetja serbe Rada Trajkoviç nga Graçanica, që kishin nënshkruar apelin me të cilin kërkojnë që Komisioni Evropian të rishqyrtojë vendimin, me të cilin Kosova është lënë jashtë procesit të liberalizimit të vizave.

Intelektualë të profileve të ndryshme, por edhe ish-figura politike, u bëjnë thirrje parlamentarëve të Bashkimit Evropian dhe liderëve të Evropës që Kosova të mos mbetet "geto", duke vlerësuar se lënia anash e Kosovës në këtë proces është politike katastrofale.

Këto thirrje dhe shqetësime të përfaqësuesve të shoqërisë civile u bëjnë gjatë një konference me gazetarë, ku u tha se apeli do t'u dorëzohet shumë institucioneve dhe mediave të ndryshme ndërkombëtare.

Luan Shllaku, nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, duke prezantuar përmbajtjen e këtij apeli, tha se janë të shqetësuar se Kosova ka mbetur jashtë këtij procesi.



"Ne, evropianët e brengosur që jetojmë në Kosovë, e mirëpresim propozimin e KE-së që t'i lejojë qytetarët e Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi të udhëtojnë pa viza në BE nga fillimi i vitit 2010. Së shpejti shpresojmë që edhe Shqipëria e Bosnja do ta gëzojnë një gjë të tillë, por shqetësohemi që Kosova ka mbetur jashtë këtyre proceseve", tha dje Luan Shllaku, nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

"Ne, evropianët e brengosur që jetojmë në Kosovë, e mirëpresim propozimin e KE-së që t'i lejojë qytetarët e Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi të udhëtojnë pa viza në BE nga fillimi i vitit 2010. Së shpejti shpresojmë që edhe Shqipëria e Bosnja do ta gëzojnë një gjë të tillë, por shqetësohemi që Kosova ka mbetur jashtë këtyre proceseve", tha ai.

Shllaku tha se janë të vetëdijshëm që shtetet anëtare të BE-së nuk pajtohen në lidhje me statusin e Kosovës, mirëpo lënia e qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh etninë, në një "geto vizash", kur i gjithë Ballkani, nga Adriatiku e deri në Detin e Zi, do mund të udhëtojnë lirshëm,

atëherë është një politikë katastrofale."

Sipas tij, BE-ja duhet të ofrojë një udhërrëfyes që çon drejt liberalizimit të vizave për kosovarët.

"Nëse nuk u dashka konsensusi i të gjitha vendeve anëtare të BE-së për ta vendosur Kosovën në listën e zezë të Shengenit, atëherë nuk do të duhej konsensus as për ta futur atë në listën e bardhë të Shengenit. Natyrisht nëse Kosova i plotëson kushtet e nevojshme", theksoi Shllaku.

Ndërkaq, kryetari i Klubit për Politikë të Jashtme, Veton Surroi, tha se liberalizimi i vizave nuk është vetëm çështje e vizave, por është edhe çështje e lëvizjes së lirë në Ballkanin Perëndimor dhe më

gjër, ku Kosova, sipas tij, do të jetë e izoluar edhe në çështje tjera integrale.

Ai tha, po ashtu, se, nëse kosovarët vazhdojnë të shkojnë para çdo ambasade në Shkup apo këtu në Kosovë, shihet se si ka degraduar qasja ndaj qytetarëve të Kosovës dhe se sot jemi shumë më keq se para 10 apo 15 vjetësh.

"Çështje tjetër është ajo e sigurisë. Fakti që Kosova do të izolohet është një pasiguri, sepse vetëm ndjenja për një gjë të tillë krijon ndjenja negative, e po ashtu edhe ata që merren me krimin e organizuar në gjithë Ballkanin kanë viza për shumë hyrje, ndërkaq qytetarët e rëndomtë nuk mund ta gëzojnë këtë të drejtë. Me këtë arsyetim nuk mund të ndalet krimi i organizuar", vlerësoi Surroi. Sipas tij, EULEX-i i mandatar nga BE nuk mund të prodhojë një gjendje të një komunikimi më intensiv sa u përket vizave.

"Kjo është një kontraktiditë e cila duhet të zgjidhet në partneritet mes kosovarëve edhe BE-së. Mu në këtë drejtim jemi përpjekje me iniciativën e ESI-t dhe me futjen e dy ministrave të brendshëm të njohur të Evropës, Amato dhe Shilling, të tregojmë këtë kundërthënie elementare", ka nënvizuar Surroi.

Ndërkaq, Verena Knaus, drejtore ekzekutive e Iniciativës Evropiane për Stabilitet - ESI, tha se është e vërtetë se procesi i liberalizimit të vizave është një proces që i shqetëson shumë njerëzit në rajon, por edhe në vendet anëtare të BE-së.

"Unë dua t'ju informoj se ish-kryeministri italian Giuliano

d'Amato dhe ish-ministri gjerman Kristian Shvartz-Shilling, konfirmuan në letërën e tyre se siguria në Evropë nuk mund të sigurohet vetëm me viza, por siguria mund të arrihet duke ofruar Kosovën dhe shtetet tjera këtë proces, dhe inkurajim të reformave sepse bashkëpunimi dhe reformat do ta bëjnë Evropën me të vërtetë më të sigurt", ka thënë Verena Knaus.

Ajo tha se ka pasur shqetësime se pse viktimat e luftës në Bosnjë dhe Kosovë nuk po përfshihen në procesin e liberalizimit të vizave, ndërsa disa të tjerë që kanë bërë krime po përfshihen në këtë proces. Knaus pretendoi se për të pasur një liberalizim të vizave, vendet duhet t'i plotësojnë kriteret teknike të Komisionit Evropian dhe fatkeqësisht Kosova dhe Bosnja nuk i kanë plotësuar. Sipas Verena Knaus, para liberalizimit të vizave duhet t'i marrim në konsideratë shqetësimet e banorëve të vendeve anëtare të BE-së të cilat kanë të bëjnë me migrimin ilegal, aspektin e sigurisë, dokumentet civile, pasaportat etj.

Ajo tha se mungesa e njohjes nga të gjitha vendet anëtare paraqet një problem tjetër për liberalizimin e vizave, mirëpo shfaq shpresën se me vetë faktin që Kosova është vendosur në listën e zezë të vizave, me plotësimin e kriterëve ajo mund të vendoset në listën e bardhë.

Ndryshe, nënshkruesit e këtij apeli presin që edhe intelektualët tjerë kosovarë të bashkëngjiten dhe të ndikojnë në sensibilizimin e Brukselit për vendimin aspak të favorshëm për Kosovën që mori Komisioni Evropian.

Vazhdojnë reagimet për bisedimet për çështje teknike ndërmjet EULEX-it dhe Beogradit

Prishtina beson se EULEX-i nuk do të lidhë asnjë marrëveshje me Beogradin në dëm të Kosovës

Qeveria e Kosovës thotë se ka pake informacione për bisedimet që po zhvillon EULEX-i me autoritetet e Beogradit. Ministrja e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, nuk beson që EULEX-i mund të lidhë ndonjë marrëveshje që cenon sistemin unik të drejtësisë në Kosovë. Ndërkaq, EULEX-i, në anën tjetër, ka përgjeshtruar Beogradin se bisedimet nuk kanë nisur, duke rikujtuar zyrtarët në Beograd se diskutimet po zhvillohen që nga marsi i këtij viti

(Vijon nga faqja e parë)

Madje, autoritetet serbe kanë paralajmëruar se nga 1 janari i vitit të ardhshëm do të formojnë trupa paralele të drejtësisë, ku përfshihen gjykata themelore, gjykata e lartë dhe gjykata për kundërvajtje në Mitrovicë dhe ato do të jenë gjykata amë për të gjithat degët në territorin e Kosovës. Por, në anën tjetër, ministrja Nekibe Kelmendi nuk beson se në çfarëdo forme EULEX-i do të pajtohej me këto diskutime me Beogradin për këtë gjykata paralele dhe ta rrezikojë kështu sistemin unik të drejtësisë, pasi që paralelizmat, sipas saj, kundërshtohen nga të gjitha institucionet e Kosovës.

"EULEX-i ka një rol të caktuar këtu, ka një mision të caktuar dhe ai brenda misionit të tij përgjigjet vet për veprimet e veta. Kurse ne,

as si Qeveria, as si Presidencë, e as si Kuvend i Kosovës, nuk pranojmë që të kemi sistem të ndarë gjyqësor", deklaroi ministrja Kelmendi.

Përderisa Beogradi deklarohet se nuk i ka nisur bisedimet me EULEX-in, zëdhënësi i këtij misioni në Kosovë, Kristof Lamfalusi, përgjeshtron autoritetet serbe duke thënë se ka bisedime dhe ato kanë nisur që nga pranvera e këtij viti.

"Ne po zhvillojmë bisedime që nga marsi, kur shefi i EULEX-it, Iv De Kermabo, ka shkuar në Beograd. Ne jemi në fazë të vazhdimit të këtyre bisedimeve për çështje të ndryshme dhe do të dëshironim të nënshkruanim tri protokolle për bisedime në lidhje me doganat, drejtësinë dhe policinë me Beogradin", thotë zëdhënësi Lamfalusi.



Sidoqoftë, marrëveshjet teknike me Beogradin, sipas zyrtarëve të EULEX-it, janë në fazën e përgatitjes të diskutimeve. Këto marrëveshje teknike thuhet se kanë për qëllim disa çështje të interesit të përbashkët, që në rënd të parë kanë të bëjnë me shkëmbim informatah me dyja vendeve. Menaxhimi i kufijve, lëshimi i

kontrolluar i pasaportave si edhe bashkëpunimi rajonal në fushën e sigurisë - policisë, janë vënë edhe si kushte nga Bashkimit Evropian për vendet e rajonit në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave, andaj zyrtarët evropianë besojnë se Beogradi do të tregojë fleksibilitet ose, në të kundërtën, do të përballat me probleme, marrë parasysh se përfshirja e Serbisë në liberalizimin e vizave i ka edhe kushtet e veta para se të zbatohet.

Me ndërhyrjet direkte të Serbisë dhe kontrollit të saj tek subjektet politike të serbëve të Kosovës, pjesa veriore, sidomos, funksionon paralelisht me sistemin legal-kushtetues të Kosovës. Dy pikat doganore atje shërbejnë për doganierët e EULEX-it vetëm për të regjistruar hyrje-daljet e njerëzve dhe mallrave, por policia doganore e Kosovës nuk ka arritur të

sigurojë edhe të hyrat apo zhdoganimin e mallrave. Ato dy pika kanë shërbyer dhe shërbejnë për zhvillimin e kontrabandës dhe dukurive tjera të jashtëligjshme. Veprimet e tilla të Serbisë, pavarësisht se është një prej vendeve që u shpërblje nga Komisioni Evropian për procesin e liberalizimit të vizave, shihen si përpjekje për të mos lejuar vendosjen e sundimit të ligjit në veri, duke e ruajtur atje statuskuonë dhe rrezikun e vazhdueshëm për tërësinë territoriale të vendit. Andaj, duke e pasur para vetes një gjendje të tillë faktike, zyrtarë të EULEX-it thonë tashmë publikisht se kthimi i gjykatësve, prokurorëve dhe doganierëve kosovarë, serbë e shqiptarë, në veri të Kosovës, është edhe një marrëveshje me Serbinë.